

P.nr.2277/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit A. K. nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës se PTH ne Prizren PP/II.nr.388-1/16, te dt.25.10.2016, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 p.6/1 te KP-së në prezencën e te akuzuarit, prokurorit te shtetit Mehreme Hoxha, me dt. 14.11.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM**I akuzuari:**

A. K. i lindur me [] ne fsh. T. tani me banim ne Prizren ne rr. [] nr. [], nga i ati I. e ema F. e lind. R. , ka te kryer fakultetin e mjeksise i martuar ibaba il femiu, mjek , i gjendjes se mesme ekonomike , shqiptar, shtetas i R. të Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.16.02.2016, rreth orës 06:50 min, ne Prizren ne rrugën transite, ne afërsi te udhëkryqit per ne autostradë, duke mos iu përmbajtur dispozitave te komunikacionit ne rruge shkel Ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron ne kundërshtim me nenin 54 teLSKRR, duke e drejtuar automjetin e markës “Opel Astra”, me shenjen regjistruese [], me ngjyre hiri kur arrin ne vendin kritik , nuk ka kpasur kujdesin e duhur gjate lëvizjes, dhe nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ne atë kthese te thelle ne te djathte te drejtimit te tij te lëvizjes, kështu që ka kaluar ne shiritin e kundërt te drejtimit te lëvizjes dhe me pjesën e parme te anës se majte e godet ne pjesën e parme te anës se majtë automjetin e markës “VW Caddy” me shenjen regjistruese [], te cilin automjet e drejtonte i dëmtuari D. N. , me te cilat veprime përpos dëmeve materiale ne automjete lëndime te lehta trupore pësojnë te dëmtuarit D. N. dhe A. N. , lëndime këto te përshkruara ne ekspertizën mjekoligjore.

Këso dore ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6-1 t eKP.


Andaj gjykata ne kuptim te nenit 41, 49, 50 51 dhe 52 te KP te akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër te re penale.

Te dëmtuarit D. N. dhe A. N. nga fsh. T. Komuna e Prizrenit, per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

Obligohet i pandehuri qe ti paguajë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato behën ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër te ekspertizës se komunikacionit shumen prej 40,44 euro si dhe ekspertiza mjekoligjore shumen prej 20,44 euro, kurse ne emër te te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.



Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.388-1/16, te dt. 25.10.2016, kundër të akuzuarit A. K- nga Prizreni, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6/1 te KP-së.

I akuzuari A. K- ne shqyrtimin fillestar, në tërësi ka pranuar veprën penale e cila i vëhet në barrë sipas aktakuzës.

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bere vullnetarisht, pranimi mbështetet ne faktet e qeshtjes qe përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjyqtari gjykues, pas marrjes së mendimit edhe nga ana e Prokurorit të Shtetit ka vlerësuar se një pranim i tillë ka mbështetje në provat të cilat i përmban aktakuza, prandaj pranimin e fajësisë e ka aprovuar.

Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6/1 te KP, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me kusht duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njejtit.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese, secilën në veçanti dhe lidhshmëri në mes tyre me të gjitha rrethanat tjera të cilat ishin me ndikim në përcaktimin dhe qëllimin e dënimit.

Si rrethanë rënduese gjykata kishte parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, kurse në rrethanat lehtësuese pranimin e fajit, shprehjen e pendimit dhe rrethanat familjare të pandehurit si dhe sjelljen e tij korrekte para gjykatës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPPK-se.

Vendimi mbi udhezimin juridik ne kontest te rregullt civil u mbeshtet ne nenin 463 par.2 i KPPK-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 2277/16 të dt.14.11.2017

Procesmbajtësja:
Halime Nixha



Gjyqtari:
Refki Piraj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit ne Prishtine, e nëpërmjet të kesaj gjykate.